

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË

KOMISIONI I DHËNIES SE KONCESIONIT FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti i kontratës Dhënie me koncesion te hidrocentralit “Kukur”

Forma e kontratës B.O.T (Ndërtim – Operim – Transferim)

Burimi i financimit Shoqëri tregtare private / Kapital privat

Vlera e parashikuar e projektit: 304,603.895 Leke (pa TVSH)

Kohëzgjatja e kontratës : 35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 23 date 12.6.2017

Njoftojmë se, kane qene pjesëmarrës ne procedure këta ofertues me ofertën përkatëse te ofruara:

Shoqëria “Doko” sh.p.k. – Skualifikohet pasi nuk ka dorëzuar ofertën dhe sigurimin e ofertës si dhe nuk ka dorëzuar te gjithë dokumentacionin e kërkuar nga shtojca nr. 9 te Dokumentave te Koncesionit.

Shoqëria “Alko – Impex General Construction” dege e shoqërisë se huaj,

Fuqia e instaluar e percaktuar me prurjen llogaritesë 4,370 kW

Prodhimi i energjisë elektrike 16,174,294 kWh

Vlera e “Fee koncesionare” 2% (323,485 kWh)

Koha e zbatimit te punimeve 36 muaj

Kosto per njesi e makinerive dhe

Pajisjeve per kW fuqi te instaluar 23,684 leke/kW

Vlera e investimit (pa TVSH) 304,603.895 Leke

Ministria e Energjisë dhe Industrisë lajmëron Z. Arbër Abazi, Përfaqësues ligjor i Degës se Përfaqësimit ne Shqipëri te Shoqërisë “Alko – Impex General Construction” dege e shoqërisë se huaj, me adrese: Rruga “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Kati 8, Tiranë, se oferta e paraqitur më datë 10 Korrik 2017, për marrjen me koncesion te hidrocentralit “Kukur”, është pranuar.

Afati i negocimit te Kontratës tuaj do te jete brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit te fituesit.

Shoqëria “Alko – Impex General Construction” dege e shoqërisë se huaj kërkohet t’i paraqesë Ministrisë se Energjisë dhe Industrisë dokumentet e mëposhtme:

Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Përgjithshme dhe te Veçanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.

Sigurimin e Kontratës sipas formës se kërkuar ne Dokumentat Standarte te Procedurës Konkurruese, ne vlerën e 10% te Investimit (pa TVSH). Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nënshkrimit te Kontratës nga te dy palët.

Ofertën origjinale e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokure) duhet te nënshkruajnë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike. Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim te

rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës.
Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.

Ne rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet te njoftoni me shkrim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.7.2017

Ankesa: Nuk ka